

RAPORT MONITORIMI
PËR ZBATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË AKISA-s
(6-mujori i parë i vitit 2026)

I. QËLLIMI

Ky raport paraqet rezultatet e monitorimit të zbatimit të masave të Planit të Integritetit të Autoritetit Kombëtar të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil (AKISA), për periudhën 1 janar – 30 qershor 2026.

Dokumenti bazë i AKISA-s përcakton gjashtë fusha kryesore të riskut dhe masat përkatëse të integritetit: investigimin teknik, konfliktin e interesit, prokurimet publike, burimet njerëzore, deklarimin e pasurisë dhe interesave private, si dhe menaxhimin e informacionit dhe dokumentacionit.

II. 6-MUJORI I PARË I VITIT 2026 – RAPORTIMI I MONITORIMIT

Për periudhën 1 janar – 30 qershor 2026 vijon zbatimi i masave parandaluese të Planit të Integritetit dhe nuk janë evidentuar raste korrupsioni apo raste të ndikimit të papërshtatshëm në proceset e institucionit.

Për 6-mujorin e parë të vitit 2026, niveli i përgjithshëm i zbatimit të masave të Planit të Integritetit vlerësohet në 100%.

Tabela 1 – Vlerësimi i zbatimit për periudhën 1 janar – 30 qershor 2026

Nr.	Fusha	Masa	Gjetja e monitorimit	Zbatimi
1	Investigimi teknik	Procedura të standardizuara sipas ICAO; publikimi i raporteve përfundimtare; trajnime.	Masat parandaluese kanë vijuar të zbatohen në kuadër të veprimtarisë institucionale. Gjatë periudhës nuk janë evidentuar raste të ndikimit të papërshtatshëm mbi procesin e investigimit.	100%
2	Konflikti i interesit	Deklarimi i konfliktit të interesit dhe shmangia e situatave të konfliktit.	Gjatë periudhës nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit që të kenë cenuar procesin e investigimit apo vendimmarrjen.	100%
3	Prokurimet publike	Respektimi i legjislationit; dokumentimi; ndarja e funksioneve dhe kontrollet.	Procedurat janë zhvilluar me respektimin e mekanizmave administrativë dhe financiarë. Gjatë periudhës nuk janë evidentuar raste korrupsioni të lidhura me këtë fushë.	100%
4	Burimet njerëzore	Procedura të standardizuara, dokumentim dhe transparencë në vendimmarrje.	Gjatë periudhës nuk janë evidentuar raste të ndikimit subjektiv të papërshtatshëm në rekrutimin, vlerësimin apo caktimin e detyrave.	100%

Nr.	Fusha	Mara	Gjatë monitorimit	Zbatimi
5	Pasuria dhe interesat private	Deklarimi pranë ILDKPKI për subjektet e detyruara dhe bashkëpunimi për verifikim.	Detyrimet përkatëse janë trajtuar sipas kërkesave të zbatueshme. Gjatë periudhës nuk janë evidentuar raste shkeljeje në kuadër të monitorimit.	100%
6	Informacioni dhe dokumentacioni	Kufizimi i aksesit sipas roleve; arkivim i sigurt; trajnime mbi etikën dhe sekretin profesional.	Gjatë periudhës nuk janë evidentuar raste të aksesit të paautorizuar ose përdorimit të papërshtatshëm të informacionit teknik.	100%

III. KONKLUZIONE

1. Për periudhën 1 janar – 30 qershor 2026, të gjashtë fushat e Planit të Integritetit rezultojnë me nivel monitorimi 100%.
2. Për këtë periudhë nuk janë evidentuar raste korrupsioni apo raste që të kenë cenuar integritetin e proceseve të investigimit, prokurimit, menaxhimit të burimeve njerëzore apo administrimit të informacionit.
3. Niveli i përgjithshëm i riskut të korrupsionit në AKISA mbetet i ulët, në përputhje me dokumentin e vlerësimit, i cili e lidh këtë me natyrën teknike, pavarësinë hetimore dhe mungesën e funksioneve rregullatore/sanksionuese.

IV. MASAT PËR VIJIMËSINË

Për periudhat pasuese rekomandohet vijimi i zbatimit të procedurave standarde të integritetit, dokumentimi i rasteve të konfliktit të interesit, respektimi i kontrolleve në prokurime, vijimi i trajnimeve mbi etikën dhe sekretin profesional, si dhe monitorimi periodik i riskut të korrupsionit. Këto masa janë në përputhje me masat e përcaktuara në dokumentin bazë të AKISA-s.

V. PUBLIKIMI DHE RAPORTIMI

Raporti, pasi të miratohet nga drejtuesi i institucionit, mund të publikohet në faqen zyrtare të AKISA-s. Në përgjigjen drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit duhet të përcillet linku i publikimit të raportit.

PËRGATITI: Jra Angoni
 DATA: 13 / 07 / 2026

MIRATOI
 Genc RESULI
 DREJTOR I AUTORITETIT

Genc Resuli
 (Firma dhe vula)

